<p>10. Kategoritë dhe sub-kategoritë janë përcaktuar në Shtojcën 3 dhe 4 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Kodifikimi i resurseve dhe rezervave minerale</p> <p>1. Klasifikimi i resurseve dhe rezervave minerale përcaktohet nëpërmjet kodifikimit, i cili bën identifikimin e kategorive të resurseve dhe rezervave minerale. Tri (3) dimensionet paraqiten në brinjët e një kubi, boshti E - Ekonomik, për vlefshmërinë ekonomike, boshti F – Fizibiliteti, për vlerësimin e shfrytëzimit dhe boshti G – Gjeologjik, për hulumtimin gjeologjik të përcaktuara në shtojcën 6 të këtij Udhëzimi Administrativ. Të tri kategoritë e qëndrueshmërisë ekonomike kanë kodet 1,2 dhe 3 në rend zbritës, në mënyrë të ngjashme të tri kategoritë e studimit të fizibilitetit kanë kodet 1,2 dhe 3, ndërsa katër (4) fazat e vlerësimit gjeologjik përfaqësohen nga katër (4) kode. Kategoria më e lartë do të ketë kodin (111) kurse ajo më e ulët kodin (334).</p> <p>2. Numrat përdoren për të projektuar klasa të ndryshme, referuar shkallës më të lartë të vlerësimit ekonomik, shkalla më e lartë e sigurisë dhe shkalla më e lartë e hulumtimeve gjeologjike, sipas shtojcave 5, 6 dhe 7 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p>3. Numri i parë një shifror i referohet vlefshmërisë ekonomike, dhe paraqet interes</p>	<p>10. Categories and sub-categories shall be defined by Annexes 3 and 4 of the present Administrative Instruction.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Codification of mineral resources and reserves</p> <p>1. The classification of mineral resources and reserves is mainly made by codification, thereby identifying categories of mineral resources and reserves. The three (3) dimensions are presented on the lines of a cube, where: E axis – Economic, for economic value; F Axis – Feasibility, for the utility appraisal; and G Axis – Geological, for the geological research as defined by Annex 6 of the present Administrative Instruction. The three categories of economic feasibility have descending codes 1, 2 and 3, and similarly, the three feasibility study categories are coded as 1, 2 and 3, while the four (4) phases of geological estimation are presented into four (4) codes. The highest category shall be coded as (111), while the lowest as (334).</p> <p>2. Numbers are used to project different classes, referring to the highest degree of economic estimation, the highest level of confidence, and the highest level of geological research, as per annexes 5, 6 and 7 of the present Administrative Instruction.</p> <p>3. The first figure shall refer to economic feasibility, and represents a major interest for</p>	<p>10. Kategorije i pod-kategorije propisane su Prilozima 3 i 4 ovog Administrativnog Uputstva.</p> <p style="text-align: center;">Član8 Kodifikovanje mineralnih resursa i rezervi</p> <p>1. Klasifikacija mineralnih resursa i rezervi vrši se kodifikovanjem, kojim se identifikuju kategorije mineralnih resursa i rezervi. Tri (3) dimenzije predstavljene su na rubovima kvadra, osa E - ekonomičnost, u smislu ekonomičnosti, osa F – izvodljivost, za procenu eksploatacije i osa G – geološki, za geološka istraživanja propisana Prilogom 6 ovog Administrativnog uputstva. Sve tri kategorije ekonomske održivosti nose šifre 1, 2 i 3 u opadajućem redosledu, a slično tome, sve tri kategorije studije izvodljivosti imaju šifre 1,2 i 3, dok su četiri (4) faze geološke procene predstavljene sa četiri (4) šifre. Najviša kategorija nosiće šifru (111) dok će najniža nositi šifru (334).</p> <p>2. Brojke se koriste da se projektuju različite klase, pozivajući se na najviši stepen ocene ekonomičnosti, najviši stepen bezbednosti i najviši stepen geoloških istraživanja, shodno prilozima 5, 6 i 7 ovog Administrativnog uputstva.</p> <p>3. Prvi jednocifreni broj poziva se na ekonomičnost i odlučujući je za rudarsku</p>
---	--	--

<p>vendimtar për kompaninë minerare dhe investitorin.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Kategorizimi i resurseve dhe rezervave minerale</p> <p>1. Resurset dhe rezervat minerale kategorizohen në:</p> <p>1.1. Resurset minerale, dhe</p> <p>1.2. Rezervat minerale</p> <p>2. Resurset minerale, janë paraqitje minerale me interes ekonomik nën ose në sipërfaqen e Tokës, në sasi dhe cilësi të mjaftueshme që garantojnë kosto efektive dhe të arsyeshme për shfrytëzim ekonomik në të ardhmen e parashikueshme. Vendndodhja, sasia, cilësia, vazhdimësia si dhe karakteristikat tjera gjeologjike të resursit/eve minerale duhet të jenë të njohura, të vlerësuara dhe të besueshme, bazuara në hulumtimet e përgjithshme gjeologjike, provat dhe njohurit tjera specifike, duke përfshirë edhe provë-marrjen. Resurset minerale janë mineralizime potencialisht komerciale, përfshirë deponit dhe mbetjet, të cilat janë të identifikuar dhe të vlerësuara me hulumtime. Resurset minerale ndahen në:</p> <p>2.1. Resurset minerale të supozuara;</p> <p>2.2. Resurset minerale të dëshmuara – shfaqura;</p>	<p>the mining company and investor.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Categorization of mineral resources and reserves</p> <p>1. Mineral resources and reserves shall be categorized into:</p> <p>1.1. Mineral resources and</p> <p>1.2. Mineral reserves.</p> <p>2. Mineral resources are mineral occurrences of economic interest, under or on earth surface, in quantities and qualities sufficiently guaranteeing effective and reasonable costs of economic utilization in a predictable future. Location, quantity, quality, sequence, and other geological features of mineral resources must be identified, estimated and probable, based on general geological research, probes and other specific knowledge, including sampling. Mineral resources are potentially commercial mineralization, including landfills and waste, which are identified and estimated by research. Mineral resources are divided into:</p> <p>2.1. Probable Mineral resources;</p> <p>2.2. Proved/indicated Mineral resources;</p>	<p>kompaniju i ulagača.</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Klasifikacija mineralnih resursa i rezervi</p> <p>1. Mineralni resursi i rezerve dele se na:</p> <p>1.1. Mineralne resurse; i</p> <p>1.2. Mineralne rezerve.</p> <p>2. Mineralni resursi predstavljaju mineralne pojave od ekonomskog interesa ispod ili na površini zemlje, u količini i kvaliteta dovoljnog da se zagarantuju efektivni i racionalni troškovi za eksploataciju u ekonomske svrhe u predvidivoj budućnosti. Ležište, količina, kvalitet, kontinuitet kao i druge geološke karakteristike mineralnih resursa treba da su poznati, procenjeni i pouzdani, zasnovani na generalnim geološkim istraživanjima, dokazima i drugim posebnim vidovima znanja, uključujući prikupljanje dokaza. Mineralni resursi predstavljaju potencijalne komercijalne mineralizacije, uključujući deponije i otpatke, koji su identifikovani i procenjeni istraživanjima. Mineralni resursi dele se na:</p> <p>2.1. pretpostavljene mineralne resurse;</p> <p>2.2. dokazano-prikazane mineralne resurse;</p>
---	---	--

<p>2.3. Resurset minerale të vlerësuara - matura.</p> <p>3. Për resurset minerale të supozuara, të dhënat gjeologjike janë të mjaftueshme për të kuptuar dhe marrë një qëndrim për përmbajtjen gjeologjike dhe/ose karakteristikat mineralogjike, por nuk mjaftojnë për verifikimin e vazhdimësisë gjeologjike dhe kategorinë.</p> <p>4. Resurset minerale të supozuara kanë nivel më të ulët të besimit se sa resurset minerale të dëshmuara - shfaqura dhe nuk mund të shndërrohen (konvertohen) në rezerva minerale.</p> <p>5. Besimi në vlerësimin e resurseve minerale të supozuara, zakonisht nuk është i mjaftueshëm për të lejuar që këto rezultate të zbatohen në pjesën teknike dhe për parametrat ekonomik që do të përdoren për planifikim të detajuar.</p> <p>6. Për resurset minerale të dëshmuara – shfaqura, të dhënat gjeologjike rrjedhin nga hulumtimet adekuate të detajuara të besueshme, me marrjen e mostrave dhe analizim të mjaftueshëm për të konfirmuar vazhdimësinë gjeologjike me shkallë të mostrimit dhe hulumtimit të mjaftueshëm.</p> <p>7. Resurset minerale të dëshmuar - shfaqura kanë nivel më të ulët të besimit se resurset minerale të vlerësuara – matura dhe mund të konvertohet në rezerva minerale të mundshme</p>	<p>2.3. Estimated/measured Mineral resources.</p> <p>3. For probable mineral resources, geological data shall be sufficient to understand and take a position on geological content and/or mineral features, but insufficient to validate geological sequence and category.</p> <p>4. Probable mineral resources have a lower level of confidence compared to proven/indicated mineral resources, and may not be converted into mineral reserves.</p> <p>5. The confidence level of the estimated mineral resources is usually insufficient to allow for such results to be applied in the technical part, and for economic parameters to be used for detailed planning.</p> <p>6. For proved/indicated mineral resources, geological data derive from adequate, detailed and confident research, sampling and sufficient analysis to confirm geological sequence at a relevant sampling and research degree.</p> <p>7. Proved/indicated mineral resources are found at a lower level of confidence in comparison to estimated/measured mineral resources, and may be converted into probable</p>	<p>2.3. procenjene – izmerene mineralne resurse.</p> <p>3. Za pretpostavljene mineralne resurse, geološki podaci dovoljni su da se shvati i zauzme stav o geološkom sastavu i/ili mineralološkim karakteristikama, ali svi oni nisu dovoljni da se verifikuje geološki kontinuitet i kategorija.</p> <p>4. Pretpostavljeni mineralni resursi imaju niži nivo pouzdanosti u odnosu na dokazano-prikazane resurse i ne mogu se prevesti (preobratiti) u mineralne rezerve.</p> <p>5. Pouzdanost procene pretpostavljenih mineralnih resursa obično nije dovoljna da dozvoli da se ovi rezultati primene u tehničkom delu i u ekonomskim parametrima koji će se upotrebiti za detaljno planiranje.</p> <p>6. Kod dokazano-prikazanih mineralnih resursa, geološki podaci proizilaze iz detaljnih i pouzdanih adekvatnih istraživanja, prikupljanjem uzoraka i dovoljnom analizom, sa ciljem da se potvrdi geološki kontinuitet sa dovoljnim stepenom uzimanja uzoraka i istraživanja.</p> <p>7. Dokazano-prikazani mineralni resursi imaju niži nivo pouzdanosti u odnosu na procenjeno-izmerene mineralne resurse i mogu da se konvertuju u potencijalne –</p>
--	---	--

<p>– besueshme.</p> <p>8. Resurset minerale të vlerësuara – matura, kanë nivel më të lartë të besimit se resurset minerale të dëshmuara - shfaqura dhe të supozuara. Mund të konvertohen në rezerva minerale të vërtetuara - provuara ose në rrethana të caktuara në rezerva minerale të mundshme – besueshme.</p> <p>9. Të resurset minerale të vlerësuara – matura, përqendrimi i mineralit (mineralizimit) mund të klasifikohet si resurs mineral i vlerësuar - matur kur mënyra, shuma e përgjithshme, cilësia dhe shpërndarja e të dhënave janë të tilla që nuk lënë asnjë dyshim të arsyeshëm, për të bërë interpretimin e sigurt gjeologjik për vazhdimësinë e mineralizimit të resurseve minerale, që sasia, cilësia dhe klasa (kategoria), shtrirja, forma dhe densitetit i të dhënave gjeologjike, karakteristikat dhe kompleksitetin e shtrirjes dhe shpërndarjes së mineralizimit mund të vlerësohen.</p> <p>10. Besueshmëria në saktësinë e vlerësimit duhet të jetë e mjaftueshme për përdorim praktik të parametrave teknike dhe ekonomike për të mundësuar vlerësimin e qëndrueshmërisë ekonomike në nivel të lartë të besimit.</p> <p>11. Rezervat minerale përfshinë sasinë e mineralit të dobishëm. Vendndodhja, sasia, cilësia, vazhdimësia si dhe karakteristikat tjera</p>	<p>mineral reserves.</p> <p>8. Estimated/measured mineral resources have a high level of confidence than proven/indicated and probable mineral resources. They may be converted into proved mineral reserves, or in certain circumstances into probable mineral reserves.</p> <p>9. In estimated/measured mineral resources, the concentration of minerals (mineralization) may be classified as an estimated mineral resource when the manner, the total amount, quality and distribution of data are such so as to level no reasonable doubt in rendering a confident geological interpretation on the sequence of mineral resource, that the quantity, quality and grading, extent, shape and density, features and complexity of extent, and mineralization distribution may be estimated.</p> <p>10. The confidence in accuracy of estimation must be sufficient for practical use of technical and economic parameters to allow estimation of economic feasibility at a high level of confidence.</p> <p>11. Mineral reserves include the amount of useful minerals. The location, quantity, quality, extent and other geological features of mineral</p>	<p>pouzdate mineralne rezerve.</p> <p>8. Procenjeno-izmereni mineralni resursi, imaju veći nivo pouzdanosti nego što je to slučaj sa dokazano-prikazanim i pretpostavljenim mineralnim resursima. Oni se mogu preobratiti u potvrđene – dokazane mineralne rezerve ili u određenim okolnostima u potencijalne – pouzdate mineralne rezerve.</p> <p>9. Kod procenjenih – izmerenih mineralnih resursa, koncentracija minerala (mineralizacija) može se klasifikovati kao procenjen – izmeren mineralni resurs, kada su način, ukupan iznos, kvalitet i raspodela podataka takvi da ne ostavljaju nikakav prostor za razumnu sumnju, sa ciljem da se izvrši sigurno geološko tumačenje kontinuteta mineralizacije mineralnih resursa, koji omogućuju da se procene količina, kvalitet i klasa (kategorija), rasprostranjenost, oblik i gustina geoloških podataka, karakteristike i složenost raspodele i rasprostranjenost mineralizacije.</p> <p>10. Verovanje u tačnost procene treba da je dovoljno za praktičnu upotrebu tehničkih i ekonomskih parametara, sa ciljem da se omogući ocena ekonomske održivosti sa visokom stopom pouzdanosti.</p> <p>11. Mineralne rezerve predstavljaju količinu korisnih minerala. Ležište, količina, kvalitet, kontinuitet kao i druge geološke karakteristike</p>
--	---	--

<p>gjeologjike të resurseve minerale duhet të jenë të njohura, të vlerësuara dhe të besueshme, bazuara në hulumtimet e detajuara gjeologjike, provat dhe njohurit tjera specifike, duke përfshirë edhe provë-marrjen. Rezervat minerale përcaktohen sipas vendburimit në tërësi dhe ndarazi sipas çdo blloku, sektori apo trupi mineral të llogaritur. Rezervat minerale duhet të llogariten duke marrë parasysh varfërimin dhe humbjet gjatë shfrytëzimit. Sasia e rezervave minerale duhet të përcaktohet me studime të para-fizibilitetit ose me studim të fizibilitetit (teknike-ekonomike). Rezervat minerale ndahen në:</p> <p>11.1. Rezervat minerale të mundshme – besueshme;</p> <p>11.2. Rezerva minerale të vërtetuara – provuara.</p> <p>12. Rezervat minerale të mundshme – besueshme, janë pjesë e rezervave ekonomikisht të matshme dhe në disa rrethana, resurseve minerale të vlerësuara – matura. Besueshmëria e faktorëve të aplikuar për rezerva minerale të mundshme – besueshme është më e ulët se sa për rezerva minerale të vërtetuara – provuara.</p> <p>13. Rezervat minerale të vërtetuara – provuara, janë rezerva minerale ekonomikisht rentabile për shfrytëzim, pjesë e resurseve minerale të vlerësuara - matura. Rezervat minerale të vërtetuara – provuara janë kategoria më besueshmërinë më të lartë</p>	<p>resources must be known, estimated and probable, based on detailed geological research, probes and other specific knowledge, including sampling. Mineral reserves are identified within the whole deposit and separately per block, sector or mineral body. Mineral reserves shall be accounted for in due consideration of impoverishment and losses in use. The quantity of mineral reserves shall be defined by pre-feasibility studies or by (technical/economic) feasibility studies. Mineral reserves are further divided into:</p> <p>11.1. Probable mineral reserves;</p> <p>11.2. Proved mineral reserves.</p> <p>12. Probable mineral reserves are part of economically measurable reserves, and in some circumstances, estimated mineral resources. The level of confidence in factors applied for probable mineral reserves is lower than that for proved mineral reserves.</p> <p>13. Proved mineral reserves are mineral reserves economically feasible for use, part of estimated (measured) mineral resources. Proved mineral reserves are in the highest level of confidence, both in technical and economic terms. In some more complex deposits, the</p>	<p>mineralnih resursa treba da budu poznate, procenjene i pouzdane, zasnovane na detaljnim geološkim istraživanjima, dokazima i drugom, posebnom znanju, uključujući i prikupljanje dokaza. Mineralne rezerve dele se u zavisnosti od ležišta u celosti i odvojeno, po svakom proračunatom bloku, sektoru ili mineralnoj pojavi. Mineralne rezerve treba da se proračunaju imajući u vidu osiromašenje i gubitke tokom eksploatacije. Količina mineralnih resursa trebalo bi da se odredi studijama pred-izvodljivosti ili (tehničko-ekonomskom) studijom izvodljivosti. Mineralne rezerve dele se na:</p> <p>11.1. Potencijalne – pouzdane mineralne rezerve;</p> <p>11.2. Potvrđene – dokazane mineralne rezerve.</p> <p>12. Potencijalno-pouzdanе mineralne rezerve, deo su ekonomski izmerivih rezervi i u nekim okolnostima, procenjenih – izmerenih mineralnih resursa. Pouzdanost faktora primenjenih na potencijalno – pouzdane mineralne rezerve niža je u odnosu na potvrđeno – dokazane mineralne rezerve.</p> <p>13. Potvrđeno – dokazane mineralne rezerve, predstavljaju ekonomski rentabilne mineralne rezerve za eksploataciju, i deo su procenjenih – izmerenih mineralnih resursa. Potvrđene – dokazane mineralne rezerve predstavljaju kategoriju višeg nivoa pouzdanosti, kako sa</p>
--	--	---


<p>të vlerësimit, si nga ana teknike ashtu edhe ekonomike. Në disa vendburime më të komplikuar, përcaktimi i rezervave në këtë kategori nuk është e mundur për shkak se punimet hulumtuese nuk mund të ofrojnë shkallë më të lartë të besueshmërisë së sasisë dhe cilësisë të rezervave dhe/ose vlerësimit e efekteve teknologjike dhe faktorëve tjerë.</p> <p>14. Në raportin e rezervave minerale, informacioni për vlerësimin e faktorëve që ndikojnë në shfrytëzim dhe përpunimin (pasurimin) e mineraleve të dobishme është komponentë shumë e rëndësishme, dhe duhet në të gjitha rastet të përfshihet në raport.</p> <p>15. Kategorizimi i resurseve dhe rezervave minerale përcaktohen në shtojcat 3 dhe 4 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p>	<p>definition of reserves in this category is not possible due to the fact that exploration cannot provide a higher level of confidence in quantity and quality of reserves and/or valuation of technological effect and other factors.</p> <p>14. In the mineral reserve report, information on assessment of factors which affect the use and processing (enrichment) of useful minerals are a very important component that must be included in the report.</p> <p>15. Categorization of mineral resources and reserves is determined in the annexes 3 and 4 of the present Administrative Instruction.</p>	<p>tehničke tako i sa ekonomske tačke gledišta. Na nekolicini komplikovanijih ležišta, određivanje rezervi u ovoj kategoriji nije moguće pošto istraživački radovi ne mogu da pruže viši nivo pouzdanosti količine i kvaliteta rezervi i/ili procenu tehnoloških i drugih faktora.</p> <p>14. Kada govorimo o mineralnim rezervama, informacija o proceni faktora koji utiču na eksploataciju i preradu (bogaćenje) korisnih minerala, predstavlja veoma značajnu komponentu i treba je uključiti u izveštaj u svim slučajevima.</p> <p>15. Klasifikacija mineralnih resursa i rezervi propisani su priložima 3 i 4 ovog Administrativnog Uputstva.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Kriteret e përgjithshme dhe forma e vendburimeve minerale</p> <p>1. Vendburimet minerale, varësisht nga karakteristikat strukturale, morfologjike, llojit të mineralizimit, ndërlikueshmërisë së formës, madhësisë, shkallës të çrregullimit tektonik, shpërndarjes së mineraleve të dobishme ndahen në:</p> <p>1.1. Vendburimet në mjedise të rregullta, me ndryshime të pritura, me kontakte fizike të theksuara;</p> <p>1.2. Vendburimet në mjedise të çrregullta</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 General criteria and shape of mineral deposits</p> <p>1. Mineral deposits, depending on structural, morphological features, type of mineralization, complexity of form, size, degree of tectonic displacement, distribution of useful minerals, are divided into:</p> <p>1.1. Deposits in regular environments, with expected alternations, with distinct physical contacts;</p> <p>1.2. Deposits in irregular environments, or</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Opšti kriterijumi i oblik mineralnih ležišta</p> <p>1. Mineralna ležišta, u zavisnosti od strukturnih, morfoloških karakteristika, vrste mineralizacije, složenosti oblika, veličine, stepena tektonske poremećenosti, raspodele korisnih minerala, dele se na:</p> <p>1.1. ležišta u urednim sredinama, sa očekivanim promenama, sa izraženim fizičkim kontaktima;</p> <p>1.2. ležišta u poremećenim sredinama ili sa</p>

<p>ose me deformime të masave të mëdha në zonat e shtrirjes;</p> <p>1.3. Vendburimet me ndryshime graduale dhe të theksuara në trashësi dhe klasë përgjatë drejtimit të shtrirjes:</p> <p>1.3.1. Vendburimet masive apo (trupat masiv) me formë të parregullta dhe klasë homogjene deri të ato johomogjene të shpërndarjes së vlerave metalore;</p> <p>1.3.2. Drejtimi i shtrirjes së trupit me ose pa ndikime tektonike, pykëzime dhe me ose pa pjesë degëzuese.</p> <p>1.4. Vendburimet - apo trupat minerale të shpërndara në hapësirë, ku mungojnë strukturat e rregullta litologjike, grupe të vogla me forma të ndryshme me origjinë vullkanike, magmatike, hidrotermale;</p> <p>1.5. Vendburimet që kanë shtrirje dhe shpërndarje të parregullt të mineraleve dhe metaleve;</p> <p>1.6. Vendburimet me përqendrim të koncentruara të rërës në aluvione, eluvione dhe koluvione të mineraleve dhe metaleve të rënda, dhe</p> <p>1.7. Shkëmbinj të dimensional të tubuar nga rrëshqitjet, rrokullisjet, shkëmbinj të sheshtë, të bashkangjitur ose të thyer, të përshtatshëm për përpunim.</p>	<p>large scale deformations in their areas of occurrence;</p> <p>1.3. Deposits with gradual and distinct alterations in thickness and grade throughout the direction of occurrence:</p> <p>1.3.1. Massive deposits or (mass bodies) in irregular shapes and homogenous grading, up to non-homogeneous distributions of metallic values;</p> <p>1.3.2. Direction of body extent, with or without tectonic impact, wedges and with or without branching areas.</p> <p>1.4. Deposits or mineral bodies distributed in space, without any regular lithological structures, smaller groups of various shapes, volcanic, magmatic or hydro-thermic origin;</p> <p>1.5. Deposits with irregular extent and distribution of minerals and metals;</p> <p>1.6. Deposits with concentrated occurrences of sand in alluvions, eluvions and colluviums of minerals and heavy metals, and</p> <p>1.7. Dimension rocks grouped due to slides, rolls, flat rocks, joined or fractured, adequate for processing.</p>	<p>deformacijama velikih srazmera u zonama prostiranja;</p> <p>1.3. ležišta sa postepenim i izraženim promenama u debljini i klasi, duž pravca prostiranja:</p> <p>1.3.1. Masivna ležišta ili (masivna tela) nepravilnog oblika i homogene do nehomogene klase raspodele metalnih vrednosti;</p> <p>1.3.2. Smer prostiranja tela, sa ili bez tektonskih uticaja, izdani i sa ili bez izdanaka;</p> <p>1.4. Ležišta – ili mineralna tela rasprostranjena u prostoru, bez redovnih litoloških struktura, manje grupe sa različitim oblicima, vulkanskog, magmatskog, hidrotermalnog porekla;</p> <p>1.5. Ležišta sa nepravilnom rasprostranjenošću i raspodelom minerala i metala;</p> <p>1.6. Ležišta sa koncentracijama peska u aluvijalnim, eluvijalnim i koluvijalnim naslagama minerala i teških metala, i</p> <p>1.7. dimenzione stene nastale naslagama klizišta, odrona, gustih, slepljenih ili slomljenih stena, prikladnih za preradu.</p>
---	---	--

<p>2. Karakteristikat e vendburimit përcaktojnë llojin dhe dendësinë e punimeve hulumtuese.</p> <p>3. Karakteristikat e vendburimeve, llojet kryesore të mineraleve si dhe shkalla e hulumtimeve që duhet të realizohen për mineralet ndërtimore, janë të përcaktuara në Shtojcën 8 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Harmonizimi i sistemeve të klasifikimit dhe raportimit</p> <p>1. Deri më 31 Janar 2020, të gjithë operatorët që merren me hulumtim dhe shfrytëzim të resurseve minerale në Republikën e Kosovës, mund të aplikojnë sistemet e vjetra të klasifikimit dhe raportimit, apo sistemin e klasifikimit dhe raportimit të përcaktuar më këtë Udhëzim Administrativ.</p> <p>2. Mënyra e harmonizimit të sistemeve për klasifikim dhe raportim, është e përcaktuar në Shtojcën 9 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p>3. Nga data 1 Shkurt 2020, të gjithë operatorët që merren me hulumtim dhe shfrytëzim të resurseve minerale në Republikën e Kosovës, aplikojnë vetëm sistemin e klasifikimit dhe raportimit të përcaktuar me këtë Udhëzim Administrativ.</p>	<p>2. Deposit features determine the type and density of exploration works.</p> <p>3. Deposit features, key types of minerals and degree of research that must be completed for construction materials, shall be defined in the Annex 8 of the present Administrative Instruction.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Harmonization of classification and reporting systems</p> <p>1. Until 31 January 2020, all operators involved in exploration and exploitation of mineral resources in the Republic of Kosovo may apply old systems of classification and reporting, or the classification and reporting system as defined by the present Administrative Instruction.</p> <p>2. The manner of harmonization of classification and reporting systems shall be provided by Annex 9 of the present Administrative Instruction.</p> <p>3. As of 01 February 2020, all operators involved in exploration and exploitation of mineral resources in the Republic of Kosovo shall apply only the classification and reporting system as defined by the present Administrative Instruction.</p>	<p>2. Karakteristike ležišta određuju i vrstu i gustinu istraživačkih radova.</p> <p>3. Karakteristike ležišta, glavne vrste minerala kao i stepen istraživanja trebalo bi da se realizuju i za građevinske minerale, propisane Prilogom 8 ovog Administrativnog Uputstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Usklađivanje sistema za klasifikaciju i izveštavanje</p> <p>1. Do 31 Januara 2020, svi operateri koji se bave istraživanjem i eksploatacijom mineralnih resursa u Republici Kosovo, mogu primenjivati stare sisteme klasifikacije i izveštavanja ili sistem klasifikacije i izveštavanja propisan ovim Administrativnim uputstvom.</p> <p>2. Način usklađivanja sistema za klasifikaciju i izveštavanje, propisan je prilogom 9 Administrativnog Uputstva.</p> <p>3. Od dana 01 Februara 2020 godine, svi operateri koji se bave istraživanjem i eksploatacijom mineralnih resursa u Republici Kosovo, primenjuju samo sistem klasifikacije i izveštavanja propisan ovim Administrativnim uputstvom.</p>
---	--	--

<p align="center">Neni 12 Hyrja në fuqi</p>	<p align="center">Article 12 Entry into force</p>	<p align="center">Član 12 Stupanje na snagu</p>
<p>Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik.</p> <p align="right">Blerand STAVILECI</p> <hr/> <p align="right">Ministër i Zhvillimit Ekonomik</p> <p align="right">Prishtinë, 29/04/2016</p>	<p>The present Administrative Instruction shall enter into force seven (7) days after it is signed by the Minister of Economic Development.</p> <p align="right">Blerand STAVILECI</p> <hr/> <p align="right">Minster of Economic Development</p> <p align="right">Prishtina, 29/04/2016</p>	<p>Ovo Administrativno uputstvo stupa na snagu sedam dana (7) od potpisivanja od strane Ministra Ekonomskog Razvoja.</p> <p align="right">Blerand STAVILECI</p> <hr/> <p align="right">Ministar za Ekonomski Razvoj</p> <p align="right">U Prištini, 29/04/2016</p>

Shtojca 1
Elementet kryesore të Sistemit të Klasifikimit



Shtojca 2

Studimi i fizibilitetit

Studimi i fizibilitetit përfshinë:

1. Kushtet gjeografike

2. Infrastruktura

- 2.1. Lehtësitë publike,
- 2.2. Rrugët, hekurudhat, etj.,
- 2.3. Fuqia punëtore.

3. Gjeologjia e vendburimit

- 3.1. Struktura, përmasa, forma,
- 3.2. Përbërja minerale, kategoria, pesha specifike,
- 3.3. Sasia e rezervave/resurseve dhe cilësia,
- 3.4. Veçoritë gjeologjike të tjera me rëndësi.

4. Çështjet juridike

- 4.1. Të drejtat dhe pronësia,
- 4.2. Studimi mbi ndikimet socio-ekonomike,
- 4.3. Miratimi publik,
- 4.4. Kërkesat ndaj Tokës,
- 4.5. Faktorët qeveritarë.

5. Operative (për punët)

- 5.1. Pajisjet minerare,
- 5.2. Metodatat minerare,
- 5.3. Plani i ndërtimit dhe afatet,
- 5.4. Provat teknologjike (pilot) të përshtatshme,
- 5.5. Fabrikat e përpunimit dhe pasurimit,
- 5.6. Rregullimi i mbeturinave (administrimi i tyre),
- 5.7. Menaxhimi i ujërave,
- 5.8. Transporti,
- 5.9. Furnizimi me energji,

- 5.10 Fuqia punëtore,
- 5.11 Projekti i mbylljes.

6. Mjedisi (nëse nuk është bërë studimi i veçantë)

7. Analiza e tregut

8. Analiza financiare

- 8.1. Kostoja e përgjithshme,
- 8.2. Kostoja e investimeve,
- 8.3. Kostoja e punës,
- 8.4. Kostoja e mbylljes,
- 8.5. Kostoja e rehabilitimit.

9. Vlerësimi i riskut

Shtojca 3

Kategorizimi i resurseve dhe rezervave minerale

Resurset dhe rezervat minerale kategorizohen në:

- **Resurset minerale**
 - Resurset minerale të supozuara - (333),
 - Resurset minerale të dëshmuara-shfaqura - (332),
 - Resurset minerale të vlerësuara- matura - (331).
- **Rezervat minerale**
 - Rezervat minerale të mundshme - besueshme – (121 dhe 122),
 - Rezerva minerale të vërtetuara - provuara – (111).

Resurset minerale të supozuara - (333), paraqesin një pjesë të resurseve minerale për të cilat, sasia, kategoria minerale dhe përmbajtja vlerësohen me një nivel të ulët të besimit. Ajo merret nga hulumtimet gjeologjike të stadi të rikognoscimit dhe janë të supozuara, nuk janë të verifikuara me hulumtime gjeologjike shtesë. Resurset minerale të supozuara bazohen në informacione të mbledhura nga hulumtimet gjeologjike me teknika të duhura, nga daljet - paraqitjet, pusët, shpimet, por këto punime janë të kufizuara dhe nuk kanë besueshmërinë e duhur.

Resurset minerale të dëshmuara (shfaqura) - (332), janë pjesë e resurseve minerale për të cilat, sasia, densitetit, forma, karakteristikat fizike, klasa dhe përmbajtja e mineraleve mund të vlerësohen me një nivel të arsyeshëm të besimit. Resurset minerale të dëshmuara bazohen në informacione të mbledhura nga hulumtimet gjeologjike me prospektim të mbështetura me teknika të përshtatshme, nga daljet (paraqitjet), pusët, shpimet, si dhe me marrjen e mostrave dhe testimin e informacionit të mbledhur. Lokacioni është i gjerë ose i papërshtatshëm për të konfirmuar vazhdimësinë gjeologjike dhe/ose klasën, por janë të mjaftueshme për të supozuar në vazhdimësi.

Resurset minerale të vlerësuara (matura) - (331), janë pjesë e resurseve minerale për të cilat, sasia, densiteti, forma, karakteristikat fizike, klasa dhe përmbajtja mineralogjike mund të vlerësohen me një nivel të lartë të besimit. Resurset minerale të vlerësuara bazohen në hulumtimet gjeologjike të përgjithshme të mbështetura me teknika të përshtatshme, nga daljet (paraqitjet), pusët, shpimet, si dhe me marrjen e mostrave dhe testimin e informacionit të mbledhur. Lokacioni është i ngushtë dhe i mjaftueshëm për të konfirmuar vazhdimësinë gjeologjike dhe/ose klasën.

Rezervat minerale të mundshme - besueshme – (121 dhe 122), paraqesin një pjesë të rezervave minerale ekonomikisht të shfrytëzueshme, dhe në disa rrethana, resurse minerale të matura (vlerësuara). Rezervat minerale të mundshme mund të varfërohen (zvogëlohen), kur shfrytëzohen me minim, atëherë lejohet kompensimi për humbjet. Këto rezerva bazohen në hulumtimet gjeologjike të përgjithshme të mbështetura me teknika të përshtatshme, nga daljet (paraqitjet), pusët, shpimet, si dhe me marrjen e mostrave dhe testimin e duhur. Këto hulumtime duhet të japin veçorit kryesore të vendburimit. Shkalla e saktësisë së hulumtimeve gjeologjike duhet të jetë e mjaftueshme për të vendosur nëse studimi i parafizibilitetit dhe hulumtimi i detajuar janë të arsyeshme. Këto vlerësime tregojnë në kohën e raportimit që shfrytëzimi është i arsyeshëm.

Shtojca 4

Kategoritë dhe sub-kategoritë

E1 - Ekonomike e mirëfilltë

- E1.1 - Ekonomike normale (Normal Economic)
- E1.2 - Ekonomike e veçantë-kushtëzuar (Exceptional Economic)

E2 – Potencialisht ekonomike (Potentially economic)

- E2.1 - Ekonomike marginale (Marginal Economic)
- E2.2 - Ekonomike submarginale (Sub-Marginal Economic)

E3 - Ekonomike të qenësishme (Intrinsically Economic)

- E3.1 - Jo për shitje (Non-sales)
- E3.2 - Të papërcaktuara (Undetermined)
- E3.3 - Të pa rikuperueshme (Unrecoverable)

F1 – Zhvillimet dhe arsyeshmëria /apo Raporti i prodhimit (Justified Development and/or Production Project)

- F1.1 - Projekti për prodhim (Project in Production)
- F1.2 – Zhvillimi i Projektit ideologjik (Committed Development Project)
- F1.3 – Zhvillimi i Projekteve neutrale (Uncommitted Development Project)

F2 - Zhvillimi i projekteve të mundshme (Contingent development Project)

- F2.1 - Sipas arsyeshmërisë (Under Justification)
- F2.2 - Të padefinuara (sqaruara) ose në pritje (Unclarified or On hold)
- F2.3 - Të pa zbatueshme (Not Viable)

F3 - Projekti i pa përcaktuar (Project Undefined)

G1 - Kushtet gjeologjike të arsyeshme dhe të sigurta (Reasonably Assured Geological Conditions)

G2 - Kushtet gjeologjike të vlerësuara (Estimated Geological Conditions)

G3 - Kushtet gjeologjike të dëshmuara (Inferred Geological Conditions)

G4 - Kushtet gjeologjike potenciale (Potential Geological Conditions)

Shtojca 5 Kodifikimi tre-shifror

KODIFIKIMI

- o Kategoritë janë të paraqitura sipas radhitjes fikse: E (Ekonomike), F (Fizibiliteti) dhe G (Gjeologjike),
- o Mbishkrimet e kategorive janë larguar, kështu që janë mbet vetëm numrat duke formuar një kod tre shifror,
- o Resurset janë të identifikuara në një kodë numerik (111,...,334), etj.
- o Lehtëson komunikimin e pavarur gjuhësor

The diagram illustrates a 3D grid of cubes representing a coding system. The vertical axis is labeled E₁, E₂, E₃. The horizontal axis is labeled G₁, G₂, G₃, G₄. A red dot is placed at the top-left-front corner of the first cube, with a red box labeled "E1, F1, G1" and an arrow pointing to it. A red box labeled "111" has an arrow pointing to the same red dot. A yellow dot is placed at the top-right-back corner of the last cube, with a yellow box labeled "E3, F3, G4" and an arrow pointing to it. A yellow box labeled "334" has an arrow pointing to the same yellow dot.

Shtojca 7
Kodifikimi

Kodi – 111	Kodi – 121	Kodi – 122
-Ekonomike (E1) -Studimi i fisibilitetit (apo Raporti i shfrytëzimit mineralar)(F1) -Hulumtimet detaje (G1)	-Ekonomike (E1) -Studimi i parafizibilitetit (F2) -Hulumtimet detaje (G1)	-Ekonomike (E1) -Studimi i parafizibilitetit (F2) -Hulumtimet e përgjithshme (G2)
Kodi – 211	Kodi – 221	Kodi – 222
-Potencialisht ekonomike (E2) -Studimi i fisibilitetit (F1) -Hulumtimet detaje (G1)	-Potencialisht ekonomike (E2) -Studimi i parafizibilitetit (F2) -Hulumtimet detaje (G1)	-Potencialisht ekonomike (E2) -Studimi i parafizibilitetit (F2) -Hulumtimet e përgjithshme (G2)
Kodi – 331	Kodi – 332	Kodi – 333
-Ekonomike të qenësishme (E3) -Hulumtimet gjeologjike (F3) -Hulumtimet detaje (G1)	-Ekonomike të qenësishme (E3) -Hulumtimet gjeologjike (F3) -Hulumtime të përgjithshme (G2)	-Ekonomike të qenësishme (E3) -Hulumtimet gjeologjike (F3) -Hulumtimet me prospektim(G3)
Kodi – 334		
-Ekonomike të qenësishme (E3) -Hulumtimet gjeologjike (F3) -Hulumtimet me rekognoscim (G4)		

Shtojca 8 Mineralet ndërtimore

Karakteristikat e vendburimeve

Vendburimet e mineraleve ndërtimore me përbërje të thjeshtë, me shtrirje dhe trashësi të qëndrueshme dhe me cilësi homogjene si dhe vendburimet me përbërje të ndërlikuar, me trashësi të ndryshueshme dhe cilësi johomogjene.

Llojet kryesore të mineraleve

Të gjitha mineralet dhe materialet të ndërlidhura që shfrytëzohen për qëllime të ndryshme në ndërtimtari, përfshirë, rërën, zhavorin, gëlqerorët (dhe shkëmbinjtë tjerë sedimentar), granitin (dhe shkëmbinjtë tjerë magmatik), mermerin (dhe shkëmbinjtë tjerë metamorfik), përfshirë argjilitet, mergelet, andezitet, bazaltin, dunitet, diabazin, tufin, rreshpet, rreshpet argjilore, gurë rrashash, ranoret, rërën kuarcore, agregatet dhe shkëmbinjtë ndërtimor, serpentinitet, periodotitet, dunitin, dioritin, diabazin, bazaltet, gabron, sienitin, gnejset dhe kuarcitet.

Hulumtimet gjeologjike për mineralet ndërtimore duhet të përfshijnë:

Boshti (Aksi) gjeologjik

G4 (Rekognoscimi)	G3 (Prospektimi)	G2 (Hulumtimet e përgjithshme)	G1 (Hulumtimet detaje)
<p>1.Rekognoscimi nga ajri Hulumtimi në distancë nga ajri (Remote sensing), hulumtimet gjeofizike nga ajri, etj.</p> <p>2.Hulumtimet gjeologjike: Harta 1:50,000 ose në përpjesë më të vogla.</p> <p>3.Hulumtimet Teknologjike/ Laboratorike: (i) Provë-marrja (Mostrimi): Të caktohet metoda optimale që i përshtatet kushteve</p>	<p>1.Hulumtimet gjeologjike: (i) Harta në shkallë 1:50,000 gjerë 1:25,000; (ii) Harta fotografjike në shkallë 1:25,000 ose në shkallë ekuivalente.</p> <p>2.Hulumtimet gjeokimike: (i) Identifikimi i përbërësve të dëmshëm, një ose dy mostra të marra nga</p>	<p>1.Hulumtimet gjeologjike: (i)Harta në shkallë 1:25,000 – gjerë 1:10,000</p> <p>2.Hulumtimet gjeokimike: Identifikimi i përbërësve të dëmshme në një ose dy mostra nga çdo mjedis; Matja e parametrave abiotike mjedisore;</p> <p>3.Teknologjike / Laboratorike: (i) Hapja e puseve, transheve një ose dy për informim; (ii)Realizimi i një ose dy shpimeve për informim/zbulim (skaut</p>	<p>1.Hulumtimet gjeologjike: (i) Hartografimi në shkallë 1:10,000 apo shkallë më të madhe; (ii) përgatitja e hartës gjeologjike me të dhëna detaje të gjitha veçorit gjeologjike të sipërfaqes, tektonikën, , shtrirjen dhe përmasat e trupave për shfrytëzim, karakteristikat gjeologjiko-inxhinjrike, etj;</p> <p>2.Hulumtimet gjeokimike: Identifikimi i përbërësve të</p>

<p>natyrore; Marrjen e mostrave të shkëmbinjve të freskët (një ose dy mostra në 5 km²); (ii) Hulumtimet dhe analiza gjeologo-inxhinjrike/fortësia, rezistenca, thyerja, poroziteti dhe dendësia, thithja e ujit, pesha vëllimore, etj. Varësisht për çka planifikohet që do të përdoret; (iii) Matja e parametrave mjedisor - fillestarë; 4.Pëmbledhje: E të gjitha të dhënave / koncepteve që janë në dispozicion. 5.Aktivitetet të lartcekura, ose më pak se që kërkohet për G3.</p>	<p>çdo njësi litologjike. 3.Hulumtimet Teknologjike/Laboratorike: (i) Provë-marrja (Mostrimi) i shkëmbinjve të freskët për varietetet dhe kualitet të ndryshme (nga një mostër); (iii)) Hulumtime dha analiza gjeologo-inxhinjrike të paktën një mostër në çdo lloj shkëmbi për përcaktimin e karakteristikave të veçanta, dendësisë, porozitetit, thithjen e ujit, forcën kompresive, elasticitetit, rezistencës në tërheqje dhe fortësinë (Varësisht për çka planifikohet që do të përdoret); 4. Hulumtimet petrografike dhe të tjera; (i)Hulumtimet petrografike dhe përbërjen mineralogjike, teksturën, mikro strukturën për çdo variant dhe pamje.</p>	<p>shpime); (iii) Provë-marrja (Mostrimi) marrja e dy deri në tri mostra për analiza të nevojshme; (iv) Përpunimi i të dhënave gjeologo-inxhinjrike, teknike, etj. 4.Hulumtimet petrografike dhe të tjera: (i)Hulumtimet petrografike përbërja mineralogjike, teksturën, mikro strukturën për çdo variant dhe pamje, (plotësimi) i të dhënave për karakteristikat petrografike dhe mineralogjike me analiza laboratorike përkatëse. (ii) Tabela e ujërave nëntokësore: matja nga çdo perspektivë.</p>	<p>dëmshëm, Matja e parametrave abiotike mjedisore; 3.Teknologjike/Laboratorike: (i)Hapja e puseve dhe transheve nëse është e nevojshme; (ii) Realizimi shpimeve për llogaritjen e rezervave dhe përcaktimin e kualitetit; (në varësi të paraqitjes, shtrirjes dhe ndërlikueshmërisë së vendburimit, shpimet në rrjetë 50-300 m.). (iii) Hulumtime dha analiza gjeologo-inxhinjrike për përcaktimin e karakteristikave të veçanta, dendësisë, porozitetit, thithjen e ujit, forcën kompresive, elasticitetit, rezistencës në tërheqje, fortësinë, përpunimin në lustrim, testin në gërryerje, etj. (Varësisht për çka planifikohet që do të përdoren); 4.Hulumtimet petrografike dhe të tjera: (i)Të dhënat për ngjyrë thërrmim, përfshirë cilësinë (kualitetin) si dhe mikrostrukturën. (ii) Tabela e ujërave nëntokësore: matja nga çdo perspektivë.</p>
---	---	---	--

	(ii) Tabela e ujërave nëntokësore: matja nga çdo perspektivë.		
--	---	--	--

Boshti (Aksi) i Fizibilitetit

F3 (hulumtimet gjeologjike)	F2 (studimi i parafizibilitetit)	F1 (studimi i fizibilitetit)
<p>1. Hulumtimet gjeologjike: (i) Harta gjeologjike me kufij dhe zona të përcaktuara, strukturën gjeomorfologjike, me analiza të nevojshme; (ii) Përcaktimi i zonave të mundshme produktive me anë të provë-marrjes dhe testimi analitik i tyre; (iii) Infrastruktura; (iv) Të dhënat mjedisore-meteorologjike dhe të dhënat paraprake mjedisore për zonën e paraparë, 2. Aktivitetet të lartcekura, ose më pak se që kërkohet për F2.</p>	<p>1. Gjeologjia: (i) Gjeologjia e zonës, hulumtimet e përgjithshme/detaje gjeologjike, përcaktimi i zonës produktive dhe përshkrimin e shkëmbinjve të dhënat për mundësit e përpunimit, hulumtimet gjeologo-inxhinjrike; 2. Shfrytëzimi: Metodat e shfrytëzimit, plani prodhimit, kërkesat për fuqi punëtore me vlerësime të përafërta. 3. Mjedisi: Me theks të veçantë në hidrogjeologji dhe hidrologji, trajtimi i mbetjeve, plani i menaxhimit; 4. Përpunimi: Të dhënat për karakteristikat fizike, mundësisë së përpunimit pas analizave laboratorike, ndërtimit të impiantit për prerje, lustrim, thërrmim, etj.; 5. Aktivitetet në Infrastrukturë, ndërtim, etj.: Përmbledhje e shkurtër. 6. Kostoja: Kostoja kapitale dhe operative me vlerësime të bazuara në operimet minerare të krahasueshme.</p>	<p>1. Gjeologjia: Hulumtime detaje (hollësishme) gjeologjike, Harta gjeologjike e zonës me shtrirje të vendburimit/ve, zona produktive, hulumtime gjeologo-inxhinjrike, etj. 2. Shfrytëzimi: Plani i Minierës/ave mënyra e shfrytëzimit/përpunimit karakteristikat, përzgjedhja e pajisjeve, makineria e rëndë kërkesat për fuqinë punëtore. 3. Mjedisi: Studimet e VNM me theks të veçantë në hidrogjeologji dhe hidrologji, duke përfshirë edhe ndikimin socio-ekonomik, rehabilitimin e personave të prekur nga projekti, deponimin e mbetjeve minerare, rikuperimin. 4. Përpunimi: Të dhënat nga hulumtimet në shkallë industriale, të dhënat e karakteristikave fizike, petrografike, lustrimi opsioni i ndërtimit të impiant, lista e pajisjeve të dhënat e fuqisë punëtore; 5. Infrastruktura dhe shërbimet, aktivitetet e ndërtimit:</p>

	<p>7.Marketingu: Një vështrim mbi aspektet e marketingut, marrëdhëniet kërkesë furnizimit, strukturën e industrisë.</p> <p>8.Qëndrueshmërinë ekonomike: Studimi preliminar (paraprak) i parashikimeve të rrjedhës së parasë.</p> <p>9.Faktorët tjerë: Dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me tokën, të punës, minierës, tatimet, etj.</p>	<p>Të dhënat e plota (detale).</p> <p>6.Kostoja: Të dhënat e detajuara për shpërndarjen e kapitalit, kostoja operative, kapitali për punë.</p> <p>7.Marketingu: Vështrim me specifikat dhe aspektet e tregut</p> <p>8.Qëndrueshmërinë ekonomike: Parashikimet e rrjedhës së parasë, efektet e inflacionit, studimet e ndjeshmërisë.</p> <p>9.Faktorët tjerë: Dispozitat ligjore që lidhen me punën, tokën, të punës së minierës, tatimet, etj.</p>
--	--	--

Boshti (Aksi) Ekonomik

(E3) Ekonomike gjerë potencialisht ekonomike (ekonomike të genësishme)	(E2) Potencialisht ekonomike	(E1) Ekonomike e mirëfilltë
<p>1.Rekognoscimi: Rekognoscimi i detajuar i zonës, të dhënat për varietetet e ngjyrave, të dhënat e përgjithshme të llojit të shkëmbinjve, karakteristikat sipërfaqësore, të përdorimit dhe statusi i tokës.</p> <p>2.Aktivitetet të lartcekura, ose më pak se që kërkohet për E2.</p>	<p>1.Hulumtime të përgjithshme dhe detaje;</p> <p>2. Identifikimi i varieteteve për shitje (tregtim);</p> <p>3. Informatë e përgjithshme për zonat pyjore/jo-pyjore dhe të dhëna të tjera të përdorimit të tokës.</p>	<p>1.Hulumtimet gjeologjike të detajuara.</p> <p>2.Raporti minerar (i shfrytëzimit)/plani i punës së minierës;</p> <p>3. Identifikimi specifik i varieteteve për shitje (tregtim);</p> <p>4. Të dhënat specifike për zonat e pyjeve/dhe atyre jo të pyllëzuara si dhe të dhëna tjera të shfrytëzimit të tokës.</p>

Shtojca 9

Harmonizimi i sistemeve të Raportimit të vjetër me atë Internacional

Një ekuivalencë e gjerë në mes të klasifikimit mund të paraqitet si:

<u>Klasifikimi i vjetër</u>	<u>Kodi Internacional i raportimit,</u>
A, B	Rezerva të vërtetuara / Resurse të vlerësuara
C1	Rezerva të vërtetuara apo të besueshme (mundshme) Resurse të dëshmuara.
C2	Rezerva të besueshme (mundshme)/ Resurse të Dëshmuara apo të supozuara.
D1	Resurse të supozuara
D2	Resurset të identifikuar me rekognoscim (kodi UNFC 334).

Kategoritë A, B, dhe C1 kanë përgjithësisht hulumtime të mjaftueshme teknike dhe ekonomike të realizuara për të interpretuar ato si rezerva. Kategoria C2 (rezerva potenciale - sipas rregullores së vjetër), në varësi të rrethanave, mund të korrespondojnë me resurse të supozuara apo shfaqura (dëshmuara) ose si rezerva të mundshme (besueshme).

Klasifikimi i vjetër lejon shfrytëzimin e rezervave (sipas teknikës dhe teknologjisë ekzistuese të shfrytëzimit) të njohur si rezerva joekonomike që janë të klasifikuara si rezerva jashtë-bilancore. Ky material është hulumtuar dhe analizuar (duke përfshirë analizat ekonomike, teknike, etj.), por që nuk është ekonomik në kushtet aktuale. Ky material nuk do të konsiderohet si “rezervë”, por mund të përshtaten si resurse të vlerësuara apo të shfaqura (dëshmuara) sipas Kodit Internacional. Për më tepër, qëllimi i klasifikimit është i njëjtë. Ky material që ka qenë subjekt i një fizibilitetit të plotë, por që nuk i përket një rezervë ekonomike për momentin.

Kur rezervat dhe resurset të klasifikuara sipas rregullores së vjetër të shprehen (shndërrohen) në kode perëndimore, është e rëndësishme që personi përgjegjës (në kuptimin e përkufizimit të Kodit Ndërkombëtar të Raportimit), ti kupton të dy sistemet, për të mundur ta kryej “konvertimin”.

